VENDIM
Nr. 11, datë 5.4.2022

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të nenit 21/3 të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, si dhe të nenit 21/5 të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"', të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë të produkteve, si më poshtë:
- 221 lekë/litri për gazoilin;
- 197 lekë/litri për benzinën;
- 103 lekë/litri për gazit të lëngshëm të naftës.
2. Miratimin e çmimit tavan të tregtimit me pakicë të produkteve, si më poshtë:
- 233 lekë/litri për gazoilin;
- 209 lekë/litri për benzinën;
- 115 lekë /litri për gazin e lëngshëm të naftës.
3. Efektet e këtij vendimi fillojnë sot më datë 5.4.2022, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës.
4. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të aktit normativ nr. 5, datë 12.3.2022, dhe nr. 8, datë 25.3.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, 'Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës të gazit dhe nënprodukteve të tyre"' , të ndryshuar.
5. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,
Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi